

ANËTARËSIMI “ACA START” KUSHTET DHE RREGULLAT E ANËTARËSIMIT

KUSHTET E ANËTARËSIMIT

Ky anëtarësim i jep anëtarit të drejtën për të përfituar nga shërbimet e pëcaktuara sipas ketyre Kushteve dhe Rregullave të Anëtarësimit

1. Anëtar - Anëtarësimi “ACA START” është i vlefshëm vetëm për personin fizik sipas të dhënave individuale (emër, mbiemër, Nr. ID personal) të cilat Anëtarit i ka dhënë në kërkesën për anëtarësim.
2. Automjeti - Anëtarësimi “ACA START” është i vlefshëm vetëm për 1 (një) automjet deri në 3.5 ton, me kushtin që emri dhe mbiemri në lejen e qarkullimit të automjetit të jete i njëjtë me emrin dhe mbiemrin e Anëtarit sipas Pikës 1 më sipër.
3. Afati - Anëtarësimi “ACA START” është i vlefshëm për vetëm 1 (një) Vit, duke nisur nga ora 00:00 e ditës pasardhëse nga dita e pagesës së tarifës së anëtarësimit..
4. Territori - Anëtarësimi “ACA START” është i vlefshëm vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Koha – shërbimi i asistencës lëvrohet sipas kushteve 24/7/365. Koha e levrimit të shërbimit të asistencës është jo më vonë se 60 minuta pas thirrjes së asistences nga Anëtar.
6. Shërbimi - Anëtarësimi “ACA START” përfshin 1 (një) shërbim asistence rrugore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në rast se distanca nga vendndodhja e automjetit të ndaluar deri në destinacioni është brenda 15 km, Anëtarit e përfiton shërbimin FALAS.
7. Shërbime bazë – shërbimet që Anëtarit përfiton FALAS brenda distancës 15 km janë: a. shërbimet e riparimit - ndezje ose karrikim dhe zvendësim baterie, fryrje dhe zvendësim i gomave, furnizim me karburant; b. transport me karroatrec. Anëtarit përfiton FALAS shërbimin dhe paguan vlerën e mallrave (goma, bateria, karburanti, etj)
8. Shërbime të tjera – Anëtarit mund të përfitojë shërbime asistence të tjera kundrejt pagesës me cmime preferenciale: brenda territorit - shërbime riparimi, mirëmbajtje, kontroll teknik, parkim; jashtë territorit: asistence rrugore, riatdhesim, etj.
9. Lloji i rrugëve – ofrimi i shërbimeve FALAS behet me kusht që automjeti të jetë në rrugë urbane, interurbane, nacionale të shtrutura dhe të asfaltuara. Në rast se automjeti ndodhet në rrugë apo terren të vecante, kostot e tjera të shërbimit i ngarkohen Anëtarit.
10. Rinovimi - Anëtarësimi rinovohet çdo vit automatikisht pasi paguhet kuota vjetore e anëtarësimit. Afati i fundit për pagesën e kuotës për rinovimin e anëtarësimit është 5 ditë pune pas skadimit të afatit të mëparshëm të anëtarësimit.
11. Anullimi – Anëtarit mund të anulohet anëtarësimin brenda afatit 14 ditë nga dita e fillimit me kusht që të mos ketë përdorur shërbimet e anëtarësimit. Nëse anëtarit ka përdorur shërbimet, anëtarësimi nuk anulohet.

SHËRBIMI I ASISTENCËS

Bazuar në Kushtet e Anëtarësimit më sipër, Anëtarit në rast se do të ketë nevojë dhe do të kërkojë shërbimin e asistences, do të ndjek hapat e mëposhtëm:

- Kontakton me shërbimin Call Center nepermjet telefonit, celularit ose emailit
 - Konfirmon të dhënat personale – Emër, Mbiemër, Nr. ID/personal
 - Dërgon foto të lejes së qarkullimit të automjetit
- Punonjësi i shërbimit Call Center verifikon të dhënat dhe konfirmon nëse ka përputhje ndërmjet të dhënave personale të Anëtarit dhe të dhënave të automjetit të ruajtura në database të anëtarësimeve.
- Në rast se të dhënat përputhen, njofton Anëtarin dhe procedon më tej për organizimin e shërbimit të asistences.
- Në varesi të specifikave të shërbimit (distanca, lloji i rrugës, mallrat, etj) punonjësi i shërbimit Call Center kalkulon kostot shtese, menyren e pagesës dhe ia komunikon Anëtarit.
- Anëtarit, nëse bie dakord me shërbimet dhe kostot përkatëse, i konfirmoni punonjësit të shërbimit Call Center levrimin e shërbimeve, mbulimin e kostove dhe menyren e pagesës.
- Punonjësi i shërbimit Call Center procedon me organizimin dhe levrimin e shërbimit të asistences rrugore.